





EDUKIMI MJEDISOR



Shkurt 2026

Edukimi mjedisor i ndihmon nxënësit të njihen me çështje të rëndësishme dhe jetike si: ujin, ajrin, tokën, natyrën, biodiversitetin. Ai është veprimtaria akademike dhe praktike, që përfshinë studimin sistematik të mjedisit dhe gjithë marrëdhënieve që e shoqërojnë; përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Përgjatë tyre nxënësit përfshihen emocionalisht dhe fizikisht; ata mësojnë për zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave të ndotjes, mbetjeve, energjisë, ekonomisë qarkulluese. Nxënësit përfshihen në mbrojtjen e natyrës dhe njëkohësisht e duan edhe më shumë atë.

"Menaxhimi i mirë i mjedisit nuk është vetëm përgjegjësi personale, por një detyrëpublike. Detyra jonë është të përdorim tokën me mençuri, dhe ndonjëherë ta lëmë tëpacenuar. Kjo është përgjegjësia jonë si qytetarë dhe thirrja jonë si kujdestarë të Tokës."

George W. Bush.

Mentorët e tyre, të cilët janë specialistët e edukimit mjedisor në të 12 AdZM-të e vendit mbështesin, përfshijnë dhe ndër marrin nisma të përbashkëta me nxënësit, për përmirësimin e mjedisve të ndryshme. Në sajë të këtyre veprimtarive ata zhvillojnë shprehje dhe dije mjedisore, që i bëjnë të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme e të mençur. Përmes edukimit mjedisor nxënësit e niveleve të ndryshme akademike përfitojnë:

vetëdije dhe ndërgjegjësim për mjedisin dhe sfidat mjedisore

kuptojnë dhe analizojnë probleme dhe çështje shqetësuese mjedisore

motivohen dhe përfshihen për përmirësimin e cilësisë së mjedisit në nivel lokal dhe kombëtar

ndërmarrin nisma dhe veprimtari që synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit



Përmes këtij manuali mujor Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura paraqet aktivitetet e zhvilluara nga 12 Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura, me nxënësit e shkollave të ndryshme në mbarë vendin dhe atyre që ndodhen pranë ZM-ve apo në zonat rurale të përgjatëmuajit shkurt 2026.

Aktivitetet janë zhvilluar në kuadër të ditëve mjedisore, promovimit të zonave të mbrojtura, lojërave të ndryshme edukative dhe argëtuese në mjediset e shkollave apo në natyrë, duke synuar gjithëpërfshirjen e nxënësve të të dy gjinive, niveleve të ndryshme ekonomike dhe vendndodhjen gjeografike.

Nxënës të përfshirë 1050

50

Shkolla të përfshira

Specialistë të angazhuar 24

52

Mësues të përfshirë

Orë mjedisore të realizuara 52

2

Universitete të përfshira



“EDUKIMI MJEDISOR”, SHKODËR



2 Shkurt 2026 – Dita Botërore e Ligatinave

Ligatinat janë ekosisteme të rëndësishme që mbrojnë biodiversitetin dhe burimet ujore. Specialistët e AdZM Shkodër zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit, ku u trajtua ndikimi imbetjeve në mjedis, veçanërisht në zonat e mbrojtura, duke i ndërgjegjësuar për pasojat e ndotjes dhe rëndësinë e ruajtjes së natyrës..

19 shkurt 2026 – Ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit nga mbetjet

Menaxhimi i mbetjeve është thelbësor për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm. Specialistët e AdZM Shkodër zhvilluan një orë mjedisore në shkollën 9-vjeçare “Agim Tafili”, ku nxënësit u njohën me pasojat e hedhjes së pakontrolluar të mbetjeve dhe u nxitën të jenë më të përgjegjshëm në mbrojtjen e mjedisit.

ditë botërore ligatinat edukim mjedisor

natyrë angazhim



“EDUKIMI MJEDISOR”, GJIROKASTËR



3 shkurt 2026 – Orë mjedisore

Një orë mjedisore mbi rëndësinë jetike të pemëve u zhvillua me nxënësit e klasës së dytë të shkollës “Koto Hoxhi”, nga specialistët e AdZM Gjirokastrër. Nxënësit mësuuan mbi rolin e pemëve në prodhimin e oksigjenit, mbrojtjen e tokës dhe ruajtjen e jetës në tokë. Përmes diskutimeve dhe shembujve konkretë, ata kuptuan se edhe veprimet e vogla ndikojnë në mbrojtjen e natyrës.

6 shkurt 2025 – Orë mjedisore

Specialistët e AdZM Gjirokastrër, përmes lojës dhe krijimtarisë, i njohën vogëlushët me kafshëte zonave të mbrojtura dhe strehat e tyre natyrore. Ata ndërtuan shtëpiza simbolike duke përdorur pambuk dhe figura të prera, duke krijuar një botë të vogël plot imagjinatë dhe ngjyra. Aktiviteti indihmoi fëmijët të kuptojnë rëndësinë e respektimit dhe mbrojtjes së kafshëve që në moshë të hershme.

12 shkurt 2025 – Flora dhe fauna në Parkun Kombëtar “Bredhi i Hotovës–Dangëlli”

Nxënësit e klasës së gjashtë u njohën me pasuritë natyrore të Parkut Kombëtar Bredhi i Hotovës–Dangëlli, një nga zonat më të rëndësishme të mbrojtura në vend. Specialistët e AdZMGjirokastër i përqendruan diskutimet në llojet kryesore të bimëve dhe kafshëve, si dhe në rëndësinë e ruajtjes së biodiversitetit. Përmes pyetjeve dhe shembujve praktikë, nxënësit reflektojnë mbi rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit.

16 shkurt 2026 – Orë mjedisore

Specialistët e AdZM Gjirkastër organizuan një orë mjedisore me fëmijët e kopshtit “Cicërimat”, ku përmes një aktiviteti krijues ata mësuuan mbi kafshët dhe habitatet e tyre natyrore. Duke përdorur materiale të thjeshta si gota letre dhe figura të prera, fëmijët ndërtuan simbolikisht shtëpizat e kafshëve dhe kuptuan rëndësinë e mbrojtjes së natyrës.



“EDUKIMI MJEDISOR”, DIBËR

04 06 19 25



4 shkurt 2026 – orë mjedisore

Zonat e mbrojtura janë thelbësore për ruajtjen e biodiversitetit dhe pasurive natyrore. Specialistë të AdZM Dibër zhvilluan një orë mjedisore në shkollën 9-vjeçare “Irfan Hajrullai” (klasa e 5-të), ku nxënësit u njohën me rëndësinë dhe kategoritë e tyre, duke u nxitur të jenë mbrojtës të natyrës.

6 shkurt 2026 – Lagunat nën kërcënim

Lagunat janë ekosisteme të brishta që kërkojnë mbrojtje të vazhdueshme nga ndotja dhe dëmtimi. Specialistët e AdZM Dibër zhvilluan një orë mjedisore në shkollën “Papa Gjon Pali II” (Ulëz), ku nxënësit, përmes aktiviteteve kreative, kuptuan rëndësinë e ruajtjes së habitateve ujore.

19 shkurt 2026 – Cikli jetësor i kafshëve

Çdo organizëm në natyrë ka një cikël jetësor që duhet respektuar dhe mbrojtur. Specialistët e AdZM Dibër zhvilluan një orë mjedisore në shkollën “Gjergj Kastrioti” (Baz), ku nxënësit u njohën me fazat e jetës së gjallesave dhe rëndësinë e ruajtjes së tyre në ekosistem.

25 shkurt 2026 – Njohja me gjurmët e kafshëve të egra

Njohja e gjurmëve të kafshëve ndihmon në kuptimin dhe mbrojtjen më të mirë të tyre. Specialistët e AdZM Dibër zhvilluan një orë mjedisore në shkollën “Papa Gjon Pali II” (Ulëz), ku nxënësit mësuuan të identifikojnë kafshët përmes gjurmëve dhe të respektojnë habitatin e tyre natyror.

orë mjedisore ndërgjegjësim

biodiversitet turizëm i qëndrueshëm



“EDUKIMI MJEDISOR”, BERAT



12 shkurt 2026 – Njohja me zogjtë e zonave të mbrojtura


Zogjtë janë pjesë e rëndësishme e biodiversitetit dhe tregues të shëndetit të ekosistemeve natyrore. Specialistët e AdZM Berat zhvilluan një orë mjedisore në shkollën “1 Maji”, ku nxënësit u njohën me disa nga zogjtë e zonave të mbrojtura, karakteristikat dhe rolin e tyre në natyrë, duke rritur ndërgjegjësimin për mbrojtjen e tyre.

edukim mjedisor zona të mbrojtura

biodiversitet



“EDUKIMI MJEDISOR”, LEZHË



2 Shkurt 2026 – Dita Botërore e Ligatinave

Në kuadër të Ditës Botërore të Edukimit Mjedisor, specialistët e AdZM Lezhë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës VII në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Karl Gega”. Gjatë aktivitetit u trajtua rëndësia e edukimit mjedisor dhe roli i zonave të mbrojtura, me fokus te Laguna e Patokut. Aktiviteti u zhvillua në mënyrë ndërvepruese përmes pyetjeve dhe quiz-eve, duke nxitur pjesëmarrjen aktive të nxënësve dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e mjedisit.

12 shkurt 2026- orë mjedisore

Habitatet natyrore janë thelbësore për mbijetesën e faunës së egër. Specialistët e AdZM Lezhë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës së parë në shkollën “Ndoc Gjetja”, ku përmes bashkëbisedimit dhe shembujve konkretë mësuan mbi rëndësinë e ruajtjes së habitateve dhe mbrojtjes së kafshëve.

16 shkurt 2026- Dita e Inxhinierëve të Pyjeve

Pyjet janë burim jete dhe kërkojnë kujdes të vazhdueshëm nga të gjithë ne. Specialistët e AdZM Lezhë, së bashku me nxënësit e shkollës “Nike Tom Prela”, realizuan mbjelljen e fidanëve të pishës, duke kontribuar në gjelbërimin e zonës dhe duke forcuar ndjenjën e përgjegjësisë përmjedisin.

21 shkurt 2026- Dita Ndërkombëtare e Guidës Turistike

Ekoturizmi promovon natyrën duke e mbrojtur atë për brezat e ardhshëm. Specialistët e AdZM Lezhë zhvilluan një orë mjedisore në shkollën “Fran Ivanaj”, ku nxënësit u njohën me rolin e guidave turistike dhe rëndësinë e promovimit të turizmit të qëndrueshëm për mbrojtjen e mjedisit.

ekosisteme ujore habitat
mbjellje fidanësh guida turistike



“EDUKIMI MJEDISOR”, DURRËS



2 Shkurt 2026 – Dita Botërore e Ligatinave

Ligatinat janë ekosisteme të çmuara që luajnë rol të rëndësishëm në ruajtjen e biodiversitetit dhe balancës natyrore. Specialistët e AdZM Durrës zhvilluan një orë mjedisore në shkollën “Hamallaj” (klasa 7), ku nxënësit u njohën me rëndësinë e këtyre habitateve, rolin e tyre në pastrimin natyror të ujërave dhe mbrojtjen nga përmytjet, si dhe u ndërgjegjësuam për ndikimin ndotjes dhe mënyrat për ta parandaluar atë.

4 shkurt 2026 – Ditëlindja e AKZM-së

Specialistët e AdZM Durrës zhvilluan një orë mjedisore në gjimnazin “Skënderbeu” në Krujë, ku përmes një workshopi informues dhe bashkëbisedimi, nxënësit u njohën me zonat e mbrojtura në Shqipëri, rëndësinë e tyre për biodiversitetin dhe rolin që ka institucioni në menaxhimin e tyre, duke u informuar gjithashtu mbi mundësitë e studimit dhe karrierës në fushën e mjedisit.

17 shkurt 2026 – Riciklimi dhe menaxhimi i mbetjeve

Riciklimi dhe menaxhimi i mbetjeve janë hapa thelbësorë për mbrojtjen e mjedisit dhe uljen e ndotjes. Specialistët e AdZM Durrës zhvilluan një orë mjedisore në shkollën “Rrushkull” (klasa 6), ku nxënësit mësuam mbi ndarjen e mbetjeve në burim, ndikimin negativ të tyre në tokë, ujë dhe ajër, si dhe u nxitën të kontribuojnë në ruajtjen e një mjedisi më të pastër në jetën e përditshme.

25 shkurt 2026 – Cikli jetësor i gjallesave

Cikli jetësor i gjallesave është një proces i rëndësishëm që ndihmon në kuptimin e zhvillimit të jetës në natyrë. Specialistët e AdZM Durrës zhvilluan një orë mjedisore në shkollën “Myrteza Hamit Pengili” (klasa 5), ku nxënësit u njohën me fazat e jetës së kafshëve përmes shembujve konkretë dhe aktiviteteve kreative, duke përforcuar njohuritë e tyre mbi natyrën dhe rëndësinë e respektimit të saj.

ligatina biodiversitet riciklim
ditë botërore natyrë



“EDUKIMI MJEDISOR”, TIRANË



ujëvara ndërgjegjësimit park natyror

orë mjedisore ditë botërore

2 Shkurt 2026 – Dita Botërore e Ligatinave

Ligatinat janë ekosisteme të rëndësishme që mbështesin biodiversitetin dhe jetën e njeriut. Specialistët e AdZM Tiranë zhvilluan një orë mjedisore në shkollën “Tufinë” ku nxënësit u njohën me rëndësinë e tyre dhe përmes një aktiviteti praktik, ndërtuan hartën e Lagunës së Karavastasë duke mësuar në mënyrë interactive dhe krijuese.

4 shkurt 2026 – Ditëlindja e AKZM-së

Specialistët e AdZM Tiranë zhvilluan një orë mjedisore në shkollën “Ymer Lala” (Surrel), ku nxënësit u njohën me zonat e mbrojtura, rëndësinë dhe menaxhimin e tyre, si dhe testuan njohuritë e fituara përmes një pyetësoi ndërveprues.

14 shkurt 2026 – Ndërgjegjësimi për habitatet

Habitatet natyrore janë thelbësore për ruajtjen e biodiversitetit dhe ekuilibrit në natyrë. Në shkollën “Hamdi Mancaku” (Zall Dajt), nxënësit, përmes lojërave dhe aktiviteteve kreative, krijuan habitate dimërore dhe pranverore, duke forcuar njohuritë dhe dashurinë për natyrën.

17 shkurt 2026 – ecje në natyrë

Eksplorimi i natyrës ndihmon në rritjen e ndërgjegjësimit dhe lidhjes me mjedisin. Specialistët e AdZM Tiranë organizuan një aktivitet në natyrë me nxënësit e shkollës “Shën Gjergj”, ku ata u njohën nga afër me bukuritë natyrore dhe rëndësinë e ruajtjes së tyre.

19 shkurt 2026 – Çfarë bëjnë kafshët në dimër?

Kafshët përshtaten në mënyra të ndryshme për të përballuar dimrin. Specialistët e AdZM Tiranë zhvilluan një orë mjedisore në shkollën “Brar”, ku nxënësit mësuan për letargjinë dhe mënyrat e mbijetesës së kafshëve, duke realizuar edhe punime kreative mbi këtë temë.

“EDUKIMI MJEDISOR”, ELBASAN



4 shkurt 2026 – aktivitet pastrimi

Specialistët e AdZM Elbasan realizuan një aktivitet pastrimi me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Veiz Çota” (Togëz), duke kontribuar në krijimin e një ambienti më të pastër dhe duke përcjellë mesazhin për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit nga mbetjet.

5 shkurt 2026 – Gjitarët në Parkun Kombëtar “Shebenik”

Fauna e Parkut Kombëtar “Shebenik” është e pasur dhe me rëndësi të veçantë për biodiversitetin. Specialistët e AdZM Elbasan zhvilluan një orë mjedisore në shkollën “Shefqet Dosku” (Dorëz), ku nxënësit u njohën me gjitarët dhe veçoritë e tyre përmes prezantimeve dhe aktiviteteve kreative.

9 shkurt 2026 – Aksion pastrimi

Specialistët e AdZM Elbasan organizuan një aktivitet pastrimi me nxënësit e shkollës së mesme “Ibrahim Muça” (Librazhd), duke nxitur ndërgjegjësimin për mbajtjen e mjedisit të pastër dhe përgjegjësinë që kanë të rinjtë ndaj natyrës.

Parku Kombëtar “Shebenik” flora dhe fauna
edukim mjedisor zona të mbrojtura

12 shkurt 2026 – Parku Kombëtar “Shebenik”

Parku Kombëtar “Shebenik” përfaqëson një pasuri të rëndësishme natyrore me biodiversitet të pasur. Specialistët e AdZM Elbasan zhvilluan një orë mjedisore në shkollën “Dilver Nezha” (Qukës), ku nxënësit u njohën me vlerat natyrore të parkut dhe, përmes aktiviteteve kreative, shprehën mesazhe dashamirësie për natyrën.

24 shkurt 2026 – Ndikimi i njeriut në biodiversitet

Ndikimi i njeriut në biodiversitet mund të jetë si pozitiv ashtu edhe negativ. Specialistët e AdZM Elbasan zhvilluan një orë mjedisore në shkollën “Isak Alla” (Zgosht), ku nxënësit diskutuan mbiefektet e veprimeve njerëzore në natyrë dhe rëndësinë e mbrojtjes së saj.



“EDUKIMI MJEDISOR”, FIER



orë mjedisore ligatinat
gjelbërim park kombëtar

2 Shkurt 2026 – Dita Botërore e Ligatinave

Ligatinat janë ndër ekosistemet më të rëndësishme për ruajtjen e biodiversitetit dhe balancësnatyrore. Specialistët e AdZM Fier, në bashkëpunim me partnerë lokalë, zhvilluan një aktivitetmjedisor me nxënësit e shkollës “Miti Zoi Zaka” (Divjakë), ku ata u njohën me rëndësinë e ligatinave dhe vizituan Lagunën e Karavastasë, duke përjetuar nga afër vlerat e saj natyrore.

4 shkurt 2026– Ditëlindja e AKZM-së

Specialistët e AdZM Fier zhvilluan një aktivitet mbjelljeje dhe pastrimi me nxënësit e shkollësprofesionale “Petro Sota”, në Peizazhin e Mbrojtur Pishë Poro–Nartë, duke kontribuar në ruajtjen mjedisit dhe duke rritur ndërgjegjësimin e të rinjve për rëndësinë e mbrojtjes së natyrës.

24 shkurt 2026 – Mbjellje në Parkun Kombëtar Divjakë–Karavasta

Mbjellja e fidanëve është një hap konkret drejt mbrojtjes dhe përmirësimit të mjedisit. Specialistët e AdZM Fier, në bashkëpunim me organizata partnere, zhvilluan një aktivitetmbjelljeje me nxënësit e shkollës “Miti Zoi Zaka”, duke nxitur përgjegjësinë dhe angazhimin e tyre për ruajtjen e pasurive natyrore.

26 shkurt 2026 – Vizitë në Parkun Kombëtar Divjakë–Karavasta

Njohja nga afër me natyrën ndihmon në rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e saj. Nxënësit e shkollës “Lili Stavre” (Fier) vizituan Parkun Kombëtar Divjakë–Karavasta, ku në Qendrën e Vizitorëve u njohën me biodiversitetin dhe rëndësinë e ruajtjes së këtij ekosistemi.

“EDUKIMI MJEDISOR”, KUKËS



2 Shkurt 2026 –Dita Botërore e Ligatinave

Në kuadër të Ditës dërkombëtare të Ligatinave, stafi i AdZM Kukës organizoi një orë mjedisore me nxënësit e klasës së 9-të të Shkollës së Mesme të Bashkuar “Ahmet Voka”, Gostil. Nxënësit u njohën me ligatinat, rolin dhe rëndësinë e tyre në ruajtjen e biodiversitetit dhe ekosistemeve natyrore. Aktiviteti përforcoi ndërgjegjësimin e të rinjve për mbrojtjen e mjedisit dhe vlerave natyrore.

4 shkurt 2026 –Ditëlindja e AKZM-së

Specialistët e AdZM Kukës zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Lidhja e Prizrenit”, Kukës. Nxënësit u njohën me misionin, rolin dhe zonat që menaxhon AdZM Kukës, duke diskutuar rëndësinë e ruajtjes së biodiversitetit dhe promovimin e praktikave të qëndrueshme. Aktiviteti u zhvillua në formë bashkëbisedimi interaktiv ku nxënësit u inkurajuan të reflektojnë mbi rolin e tyre si qytetarë aktivë në mbrojtjen e natyrës dhe pasurive natyrore të zonës.

12 shkurt 2026 – Orë mjedisore

Specialistët e AdZM Kukës zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Sali Bruka”. Gjatë aktivitetit, nxënësit u informuan mbi vlerat e biodiversitetit dhe ndikimin pozitiv që ka mbjellja e bimëve për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe të mjedisit përreth. Aktiviteti synonte të inkurajonte pjesëmarrjen aktive të nxënësve në gjelbërimin e ambientit shkollor dhe ruajtjen e natyrës.

Alpet e Shqipërisë habitate ditë botërore
zona të mbrojtura

18 shkurt 2026 – Orë mjedisore

Në kuadër të edukimit mjedisor, specialistët e AdZM Kukës organizuan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare Beslidhja e Malesisë, Tropojë. Nxënësit u njohën me shembujkonkretë nga zonat e mbrojtura që menaxhon AdZM Kukës dhe u diskutua rëndësia e ndërgjegjësimit qytetar dhe përfshirjes së komunitetit në ruajtjen e natyrës.

26 Shkurt 2026 – Dita Botërore e Energjisë së Qëndrueshme

Dita Botërore e Energjisë së Qëndrueshme ka për qëllim të rrisë ndërgjegjësimin për përdorimin burimeve të energjisë në mënyrë të qëndrueshme dhe për mbrojtjen e mjedisit. Në këtë kuadër, AdZM Kukës organizoi një orë mjedisore me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar "Bushtricë". Nxënësit u njohën me konceptin dhe parimet e energjisë së qëndrueshme, format e energjisë së rinovueshme dhe rolin e tyre në ruajtjen e natyrës. Aktiviteti nxit ndërgjegjësimin dhe përgjegjësinë për përdorimin racional të burimeve energjetike.



“EDUKIMI MJEDISOR”, KORÇË



ligatina ndërgjegjësim orë mjedisore
biodiversitet riciklim zona të mbrojtura



2 Shkurt 2026 Dita Botërore e Ligatave

Në shkollën “Ismail Gjata” Cangonj, PK Prespë, me nxënësit e klasës së 5-të specialistët e AdZM Korçë, zhvilluan një aktivitet edukues mbi ligatinat. Nxënësit u njohën me rëndësinë e tyre dhe krijuan postera duke pikturuar ligatina dhe speciet që jetojnë në to, duke nxitur kreativitetin dhe ndërgjegjësimin mjedisor.

4 shkurt 2026 – Orë mjedisore

Në Universitetin “Fan S. Noli” Korçë, studentët e degës Turizëm morën pjesë në një orëmjedisore të organizuar nga specialistët e AdZM Korçë, ku u diskutua mbi zonat e mbrojtura dhe rëndësinë e tyre. Aktiviteti synoi rritjen e njohurive dhe interesit të studentëve për trashëgiminë natyrore.

16 Shkurt 2026 – Dita e Inxhinierit të Pyjeve

Në shkollën “Kozma Basho” PMTU Pogradec, me nxënësit e klasës së 9-të u zhvillua një orëmjedisore në kuadër të Ditës së Inxhinierit të Pyjeve. Specialistët e AdZM Korçë ndanë eksperiencat e tyre profesionale, duke shpjeguar rolin thelbësor të inxhinierëve të pyjeve në menaxhimin dhe mbrojtjen e zonave të mbrojtura. Aktiviteti synoi të rrisë ndërgjegjësimin e nxënësve mbi rëndësinë e këtij profesioni për ruajtjen e ekosistemeve natyrore.

18 shkurt 2026 – Orë mjedisore

Në shkollën “Muharrem Çollaku” PMTU Pogradec, specialistët e AdZM Korçë me nxënësit e klasës së 11-të zhvilluan një aktivitet informues mbi zonat e mbrojtura, i kombinuar me një ecjenë natyrë tek Burimet e Drilonit. Nxënësit vrozuan peizazhin me dylbi dhe u ndërgjegjësuam përrëndësinë e ruajtjes së natyrës.



19 shkurt 2026 – Orë mjedisore

Mbrojtja e mjedisit dhe edukimi i hershëm për riciklimin janë thelbësore për formimin e sjelljevetë qëndrueshme tek fëmijët. Në institucionin “Stavri Themeli”, me fëmijët e grupit parashkollor zhvillua një aktivitet krijues nga specialistët e ADZM Korçë, duke përdorur materiale të riciklueshme. Përmes lojës dhe artit, fëmijët u njohën me rëndësinë e riciklimit dhe mbrojtjes së mjedisit.

20 shkurt 2026 – Orë mjedisore

Edukimi mbi botën bimore ndihmon në rritjen e ndërgjegjësimit për ruajtjen e ekosistemeve dhe biodiversitetit. Në shkollën “Omiros”, me nxënësit e klasës së 5-të specialistër e AdZM Korçë, realizuan një prezantim mbi pjesët e bimëve dhe funksionet e tyre, duke kontribuar në rritjen e njohurive për rëndësinë e mbrojtjes së natyrës.

21 shkurt 2026 – Aktivitet në natyrë për Ditën e Guidës Turistike

Aktivitetet në natyrë janë një mënyrë e rëndësishme për të nxitur respektin dhe dashurinë për mjedisin. Specialistët e AdZM Korçë organizuan me nxënësit e klasës së 9-të të shkollës “Papa Kristo Negovani”, Kolonjë, një aktivitet hiking në zona të mbrojtura, ku ata u njohën me biodiversitetin dhe vlerat natyrore të zonës.

27 shkurt 2026 – Aksion mbjelljeje për një mjedis më të gjelbër

Mbjellja e pemëve është një nga veprimet më të rëndësishme për përmirësimin e cilësisë së mjedisit dhe luftimin e ndryshimeve klimatike. Në shkollën “Omiros”, Korçë, me nxënësit e klasës së 4-të, u organizua një aksion mbjelljeje fidanësh, duke nxitur ndjenjën e përgjegjësisë ndaj natyrës dhe rolit të tyre në mbrojtjen e





2 Shkurt 2026 – Dita Botërore e Ligatinave

AdZM Vlorë organizoi një orë mjedisore në Lagunën e Nartës, një nga ekosistemet më tërëndësishme ligatinore në vend. Studentët e Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë u njohën me rëndësinë ekologjike të lagunës, rolin e saj në ruajtjen e biodiversitetit dhe u praktikuabirdwatching për të vëzhguar disa nga speciet karakteristike të shpendëve.

9 shkurt 2026 – Orë mjedisore mbi rëndësinë e zonave të mbrojtura

Edukimi mjedisor është çelësi për të mbrojtur natyrën dhe pasuritë tona natyrore. Specialistët e AdZM Vlorë zhvilluan një orë mjedisore në shkollën 9-vjeçare “Urani Rumbo”, ku nxënësit u njohën me vlerat e Parkut Natyror “Syri i Kaltër”, rëndësinë e biodiversitetit dhe nevojën për ruajtjen e burimeve ujore.

17 shkurt 2026 – Orë mjedisore mbi protokollet e monitorimit të kamerave kurth

Studentët e degës Biologji të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë u përfshinë në një orë mjedisore nga stafi i AdZM Vlorë mbi përdorimin dhe protokollet e monitorimit të kameravekurth. U diskutua rëndësia e zonave të mbrojtura dhe iu mësuara studentëve si të vendosen dhekontrollohen materialet e kamerave për të monitoruar speciet e ndryshme.

ligatina ndërgjegjësim orë mjedisore

breshka detare biodiversitet